

L I G J
Nr.7963, datë 13.7.1995

PËR PRIVATIZIMIN E SEKTORIT ELEKTROENERGJETIK

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit 7491 datë 29.4.1991, “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, në paragrafin e dytë të nenit 3, pas fjalëve “të ekonomisë kombëtare” hiqen fjalët “industria e energjetikës”.

Neni 2

Privatizimit i nënshtrohet shpërndarja, gjenerimi dhe transmetimi i energjisë elektrike.

Neni 3

Privatizimi fillon me shpërndarjen dhe gjenerimin.

Neni 4

Lejohen investime të reja private në të gjithë sektorin elektroenergjetik.

Neni 5

Forma kryesore e privatizimit të sektorit elektroenergjetik (KESH), do të jetë ajo me shoqëri anonime me paketë kontrolluese. Formula e mbajtësve të aksioneve do të përcaktohet nga Kuvendi Popullor.

Neni 6

Rregullimi i marrëdhënieve midis qeverisë, privatit dhe konsumatorit do të bëhet nga Enti Rregullues, veprimtaria e të cilit do të miratohet me ligj të veçantë.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekreten nr.1162, datë 31.7.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha